

KOMUNIKATË E POLITIKAVE

EJL Reagon ndaj Krizës Globale - Rekomandime nga NALAS

(PËRFUNDIME nga tryeza e rrumbullakët për "Decentralizimin fiskal në EJL në kontekstin e krizës financiare globale" të mbajtur në MBLEDHJEN E IV TË ASAMBLESË GJENERALE TË NALAS-it, të mbajtur më 23-24 nëntor 2008 në Tiranë)

Anëtarët e NALAS-it, drejtorët ekzekutivë të asociacioneve të pushteteve lokale, ekspertët e dalluar të makroekonomisë dhe Kryetarët e komunave nga Evropa juglindore kanë diskutuar për pasojat e mundshme nga kriza globale ekonomike në pushtetet lokale në EJL. Fillimisht është vlerësuar që efektet e përhapjes së krizës globale nuk janë ndier fuqishëm nga pushtetet lokale në EJL. Përderisa shtetet me ekonomi më të zhvilluara tashmë janë kapluar nga recesioni (papunësia, falimentimet, bankrotimet e korporatave dhe zvogëlimet e çmimeve janë vërejtur në të gjitha vendet), ekonomitë tjera mund të goditen nga zvogëlimi i investimeve të huaja direkte, humbja e investimeve lokale, zvogëlimi i neto-eksportit, zvogëlimi i remitencave nga diaspora, kurset e këmbimit, zvogëlimi i vlerës së pronës, etj. Vështirë është që ndonjë shtet t'i shmangët pasojave të caktuara ekonomike dhe sociale.

Pushtetet lokale në EJL duhet të jenë të gatshme për ballafaqim me rrezikun, por edhe të fitojnë nga mundësitë që mund të shfaqen. Pushteti qendror duhet të mbështetet në pushtetet lokale për miratimin e shpejtë të politikave, me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë në kushtet e vështira. Së këndejmi, qeveritë qendrore dhe lokale duhet ta intensifikojnë dialogun dhe bashkëpunimin. Pushtetet lokale duhet t'i identifikojnë projektet e investimeve kapitale më të nevojshme, për të cilat qeveritë qendrore mund të vendosin t'i financojnë, si një prej mjeteve për zbutjen e pasojave nga kriza ekonomike.

Nga diskutimi janë nxjerrë rekomandimet në vijim:

Porosia për qeveritë qendrore në EJL:

Në rrethanat e reja të krizës globale ekonomike, **NALAS kërkon nga qeveritë qendrore në EJL:**

1. **Ta intensifikojnë dialogun me qeveritë lokale përmes asociacioneve të tyre.** Rrjedhja e informatave mes qeverisë qendrore dhe lokale për drejtimin gjeneral të ekonomisë dhe indikatorët e paralajmërimit të hershëm duhet të vendosen dhe përmirësohen. Nga ana tjetër, kjo do ta mundësojë:
 - planifikimin më efektiv të pushteteve lokale dhe caktimin në specifik të prioriteteve,
 - identifikimin e hershëm të problemeve që shfaqen në territore ose industri të caktuara,
 - programimin e përbashkët të shpenzimeve parandaluese, që sigurohet nga dialogu i intensifikuar. Konkretisht, qeveritë qendrore duhet t'i rrisin investimet publike për nxitjen e

aktiviteteve ekonomike. Në këtë drejtim, duhet të bashkëpunojnë ngushtë me pushtetet lokale për dotacionet e dedikuara, me të cilat sigurohet që investimet e përgatitura mirë nga pushtetet lokale i plotësojnë kërkesat.

2. **T'i përkrahin pushtetet lokale në shfrytëzimin e programeve dhe fondeve të BE-së në dispozicion**, përfshirë fondet strukturore për shtetet-anëtare të BE-së dhe IPA për shtetet kandidate. Mjete plotësuese duhet t'i jepen pushteteve lokale për bashkëfinancimin e projekteve IPA, si dhe për tejkalimin e zbrazësirave financiare gjatë implementimit të projekteve, me qëllim të sigurimit të likuiditetit.
3. Të jenë të gatshme dhe t'i nxisin **format e reja, inovative, madje edhe joformale të dialogut gjatë krizës**.
4. Në fund, në rastet kur **borxhi i vjetër komunal** e ngarkon sektorin dhe ekonominë në tërësi, ky është momenti i duhur **për t'i ndihmuar pushteteve lokale në pastrimin e evidencës**.

Porosia për pushtetet lokale në EJL:

Me qëllim të parandalimit dhe mënjanim të pasojave nga kriza ekonomike lokale në bashkësitë e tyre, **NALAS i këshillon pushteteve lokale në EJL që:**

1. Të kenë qasje të kujdesshme me projeksionet buxhetore për vitin 2009 dhe 2010 përmes:
 - shfrytëzimit të inflatorëve tepër konzervativë për rritjen e BPV-së dhe shkallës së inflacionit;
 - vlerësimit shumë konzervativ të të hyrave tatimore;
 - shqyrtimit të kontratave debituese dhe llogaritjes së ekspozimit ndaj fluktuimeve të kursit të këmbimit; në rastet e mundshme të bëhen përpjekje për zvogëlimin e këtij ekspozimi;
 - shfrytëzimit maksimal të fondeve të granteve;
 - identifikimit të rreziqeve të mundshme buxhetore.
2. T'i shqyrtojnë kontratat debitorë, ta vlerësojnë ekspozimin ndaj rrezikut dhe të bëjnë përpjekje ta zvogëlojnë në rastet e mundshme.
3. T'i mbikëqyrin kompanitë/punëdhënësit e mëdhenj (përfshirë edhe ndërmarrjet publike) që mund të ballafaqohen me lëshime nga puna ose mbyllje të kapaciteteve dhe të angazhohen në masa proaktive për ballafaqim me ndryshimet serioze në tregun lokal të forcës së punës.
4. Të përgatisin katalog të projekteve investuese që mund të implementohen shpejtë, me përkrahje të qeverisë nacionale (investimet për efikasitet energjetik mund të jenë projekte adekuate afatshkurte).
5. T'i shmangen lëshimit të nëpunësve nga vendet e punës, në qoftë se është e mundur. Mbani ekspertët e kualifikuar. Mund të ketë mundësi të reja për rekrutimin e kuadrit me kualifikim të lartë, që do të shfaqet në tregun e punës gjatë recesionit.
6. Lidhuni me qytetarët dhe shpjegoni se çka pritni, çka bëni dhe pse e bëni këtë. Siguroni qytetarët që në këto kohë të vështira nuk planifikoni t'i rrisni tatimet. Por, për ta siguruar drejtësinë dhe barabarësinë, ju duhet të siguroheni që të gjithë e paguajnë pjesën e tyre.

Porositë për asociacionet e pushteteve lokale:

Asociacionet e pushteteve lokale - anëtare të NALAS-it përkushtohen për:

1. Përkrahjen e pushteteve lokale në shpejtimin e procedurave, zvogëlimin e burokracisë, krijimin e klimës së volitshme për investuesit;
2. Përkrahjen e pushteteve lokale në zvogëlimin e shpenzimeve përmes tenderimit më të mirë, përmirësimit të kapacitetit profesional dhe mbikëqyrjes së borxheve;
3. Përkrahjen e pushteteve lokale në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike komunale përmes prezantimit të sistemit të kriterëve për pushtetet lokale;
4. Vazhdimin e këmbimit të përvojave të mira për trajtimin e krizës.

Në fund, pjesëmarrësit e diskutimit kanë argumentuar dhe nënvizuar që qeveritë qendrore në EJL duhet të **vazhdojnë me decentralizimin e shpejtë dhe të vërtetë**, duke i dhënë **autonomi adekuate fiskale** pushteteve lokale, me të cilat do të jenë të afta për përmirësimin e gjenerimit të të hyrave dhe sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët.

Diskutimi i tryezës së rrumbullakët është moderuar nga

Ginka CHAVDAROVA dhe Gabor PETERI

Folës-mysafirë kanë qenë

Paul Bernd SPAHN, Joze MENCINGER, Arben MALAJ, Mitar MATIJASEVIC

Delegatët e NALAS-it që kanë marrë pjesë në tryezë:

Tarzan MILOSEVIC, Mirko BRULC, Refik RRUGIJA, Artur KURTI, Naim ISMAILI, Uros BREZAN, Rami QERIMI, Zdravko KRSMANOVIC, Penka PENKOVA, Alexandru AMBROS, Andrei VACARCIUS, Dusan DJOKOVIC, Zivko MARKOVIC, Gzim HAJDINAGA, , Sener CELIKAYAR

Mysafirët tjerë:

Z. Shrafedin SHEHU, Zv/Ministër i Financave i Shqipërisë, etj.